

UNMIK/REG/2005/40
8 gusht 2005

RREGULLORE NR. 2005/40

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/11 MBI
TATIMIN NË VLERËN E SHTUAR NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në përputhje me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/11 e datës 31 maj 2001) për tatimin në vlerën e shtuar në Kosovë),

Pasi që është shpallur Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/11 e datës 31 maj 2001 për tatimin në vlerën e shtuar në Kosovë,

Pas konsultimeve me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal,

Me qëllim të heqjes së të drejtës për kthimin e tatimit në vlerën e shtuar, të cilën e kanë organizatat joqeveritare me status të beneficuar publik,

Me anë të kësaj shpall si në vijim:

Neni 1
Ndryshimi

Që nga data kur kjo Rregullore hyn në fuqi, neni 13.2 (b) i Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/11 do të shlyhet.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm